Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike
Ministarstvo digitalizaciju i javnu upravu - Ministry of Digitalization and Public Administration

---

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë
Departament za upravljanje javnim službenicima-Department for Management of Public Officials

Datë:17/11/2026
KSHVD/03/2026

Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në pajtim me dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, me datë 17.07.2026 publikon këtë:

RISHPALLJE PUBLIKE

Për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm për anëtar të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë

Anëtari si ekspert i jashtëm i Komisionit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë duhet të plotësojë kriteret si në vijim:

1. të ketë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;

2. të ketë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave pesë (5) vite në pozita të nivelit menaxherial;

3. të mos ketë qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;

4. të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale me burgim më shumë se një (1) vit;

5. të mos jetë i punësuar në shërbim civil;

6. të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore.

Kandidatët me rastin e aplikimi duhet ti të dorëzojnë dokumentet në vijim:

1. Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuara jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;

2. Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues, Dëshmitë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështen së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal;

3. Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;

4. Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente;

5. Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;

6. Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë të gjitha ata që i plotësojnë kriteret e shpalljes të aplikojnë për anëtar si ekspert i jashtëm i Komisionit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Kandidatët e përzgjedhur për anëtar të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, do të kenë mandat tre (3) vjeçar.

Anëtari si ekspert i jashtëm i Komisionit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë dhe i Komisionit disiplinor për nivelin e lartë drejtues, përfiton pagesë në vlerë prej 20 % të pagës bazë të kryesuesit për çdo procedurë disiplinore në të cilën merr pjesë.

Afati për dorëzimin e propozimeve për anëtar si ekspert i jashtëm i Komisionit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, është i hapur nga data 17-11-2026 deri më datë 01-12-2026.

Kandidatët dokumentet e nevojshme për aplikim mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: shemsi.haxha@rks-gov.net

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 60 706 ose në email adresën: shemsi.haxha@rks-gov.net